



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 256/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.05.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Rikonstruksion i rrugës “Alit Gjeriti”, Patos*”, me nr. REF-00204-12-19-2018, me fond limit 13,328,682 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
- Ankimues:** BOE “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa Al” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Adem Jashari”, Nd.4, H.10, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Patos
Adresa: Lagjia “Naftëtari”, Rr. “Unaza”, Patos.
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k.
Adresa: Rruga Nacionale Ballsh – Fier, Fier.
- Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 20.12.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Rikonstruksion i rrugës “Alit Gjeriti”, Patos*”, me nr. REF-00204-12-19-2018, me fond limit 13,328,682 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2 Në datën 28.01.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 26.02.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Shkëlqimi 07” sh.p.k	8,000,000 lekë, Skualifikuar;
2. “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k.	9,129,835 lekë, Skualifikuar;
3. “B 93” sh.p.k & ”Riviera” sh.p.k.	9,648,550 lekë, Skualifikuar;
4. “Sark” sh.p.k	10,160,695 lekë, Skualifikuar;
5. “Sireta 2F” sh.p.k	11,111,000 lekë, Skualifikuar;
6. “Sardo” sh.p.k & ”Labi” sh.p.k.	11,111,300 lekë, Skualifikuar;
7. “Arbëria” sh.a	11,862,665 lekë, Kualifikuar;

II.4.Në datën 01.03.2019 BOE “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 622/4 Prot. datë 07.03.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k., duke e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.6. Në datën 12.03.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Shkëlqimi 07” sh.p.k	8,000,000 lekë, Kualifikuar;
2. “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k.	9,129,835 lekë, Kualifikuar;
3. “B 93” sh.p.k & ”Riviera” sh.p.k.	9,648,550 lekë, Kualifikuar;
4. “Sark” sh.p.k	10,160,695 lekë, Skualifikuar;
5. “Sireta 2F” sh.p.k	11,111,000 lekë, Skualifikuar;
6. “Sardo” sh.p.k & ”Labi” sh.p.k.	11,111,300 lekë, Skualifikuar;
7. “Arbëria” sh.a	11,862,665 lekë, Kualifikuar;

II.7.Në datën 15.03.2019 BOE “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07”, sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.8. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 712/4 Prot. datë 25.03.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.9.Në datën 29.03.2019 BOE “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]II.1. Kundërshtojmë me forcë si rast i paprecedent kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” Sh.p.k duke argumentuar si më poshtë: Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” Sh.p.k ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët referuar ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, (i ndryshuar) Neni 56 “I . Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të

informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. ” Dhe në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 % e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...] ” Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, shoqëria jonë konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, shoqëria jonë gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Shoqëria jonë gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Shoqëria jonë gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. Shoqëria jonë, gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, shoqëria jonë, thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligj i është përcaktimi i rregullave

që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Referuar parashtrimeve me shkrim marë nga rubrika kërkesë për sqarim rezultoi se në 13.02.2019 autoriteti kontraktor ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k, mbi ofertën ekonomike e cila rezultoi anomalisht e ulët në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar duke kërkuar “Argumentim të cmimeve të sejcilit prej zërave të punimeve, duke i shoqëruar detyrimisht me analiza teknike të cmimeve”. Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” Sh.p.k nëpërmjet shkresës datë 15.02.2019 numër 152/1.prot i ka kthyer përgjigje kërkesës së autoritetit kontraktor duke sqaruar: “1. Mbi punimet e gërmimit, shtresave, mbushje, ngieshje, rrafshim, sistemim etj e mbështesim ofertën mbi disponibilitetin e dysfishit të kapaciteteve të mjeteve që janë në pronësi të shoqërisë sonë. 2. Furnizimi me karburant i mjeteve do të kryhet në pikën e karburantit në pronësi të shoqërisë “Shkëlqimi 07” Sh.p.k, c’ka bënë të jemi para një rrethane tejet favorizuese mbi koston e lëndës djegëse të mjeteve 3. Mbi zërat dhe volumet “stabilizant” etj, jemi mbështetur në përparësin, që disponojmë dhe kemi në pronësi të shoqërisë “Shkëlqimi 07” Sh.p.k “Nyjen e inerteve”, pika e inerteve me sipërfaqe 12.600 m2, në pronësi të shoqërisë “Shkëlqimi 07” Sh.p.k..... 4. Kusht favorizues në kosto, për zërat “Punime shtresash asfaltike”, përmendim fabrikën e Asfalto Betonit, dhe nënprodukteve asfaltike në pronësi të shoqërisë “Shkëlqimi 07” Sh.p.k të ndosur vetëm 6 km nga objekti i tenderit, si dhe më tepër disponimi i gjendje bitumi dhe materialeve përkatëse bëj në që të kemi një kosto më të ulët të zërit të binderit, konglomerat dhe punime asfaltike. 5. Shoqëria “Shkëlqimi 07” sh.p.k ka një staf të kualifikuar në fushën e ndërtimit dhe rikonstruksionit të infrastrukturës rrugore dhe ninxhinier me mbi 25 vite përvojë 6. Shoqëria “Shkëlqimi 07” sh.p.k vë në dispozicion e kontenier-zyra që mund të pozicionohen në kantierin e ndërtimit. Gjithashtu disponojmë mjete transporti tip autobus i cili do të përdoret për transportimin e punonjësve, në mënyrë që ky i fundit të kryhet konform rregullave të Kodit të Punës

II.1.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezultoi se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Shoqëria jonë konstaton se ankimuesi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi, kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Akoma edhe më tej, referuar shkresës datë 15.02.2019 “Argumentim i ofertës” së paraqitur nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k rezultoi se është deklaruar se për pjesën më të madhe të materialeve të preventivit kemi fabrika prodhuese për këto materiale ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar nëpërmjet faturave tatimore se sa është kosto e materialeve megjithëse fabrika është në pronësi të tij. Shoqëria jonë vëren se shoqëria “Shkëlqimi 07” Sh.p.k, përveç argumentimit të vet në formën e një analize vetdeklarativ, nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse kërkuar me vlera konkrete materialesh apo me ekzistencën e stokëve ende të pashitura. Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” Sh.p.k ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e punimeve pranë autoritetit

kontraktor. Paraqitja e zërit të preventivit i pashoqëruar me dokumentacionin shitesë provues nuk mund të konsiderohet si provë pasi në vetvete nuk provon dhe garanton ofertën ekonomike si dhe realizimin e punimeve. Gjithashtu nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar prej nesh nëpërmjet rubrikës kërkesë për sqarim në faqen online të agjencisë së prokurimit publik, nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e punimeve në referim të gërmës ç, neni 56 pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi provueshmeria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e punimeve por për realizimin e tyre sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurues të ofertuar. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, shoqëria jonë gjykon se nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. .

II.1.2 GJITHASHTU ESHTE E RENDESISHME TE THEKSOHET SE KOMISIONI I VLERESIMIT TE OFERTAVE KA KRYER RIVLERESIM PA INICIMIN E PALEVE PER OFERTEN EKONOMIKE TE OPERATORIT EKONOMIK “SHKELQIMI 07” SH.P.K. OPERATORI EKONOMIK “SHKELQIMI 07” SH.P.K KA QENE I S’KUALIFIKUAR PREJ AUTORITETIT KONTRAKTOR SI OFERTE ANOMALISHT E ULET MEGJITHESE KISHTE DHENE SHPJEGIMET PER OFERTEN E TIJ EKONOMIKE. PRA NUK KUPTOHET-SESI AK-JA KA KUALIFIKUAR OFERTEN E SHOQERISE “SHKELQIMI 07” SH.P.K KUR KY I FUNDIT NUK PASKA BERE ASNJEHERE ANKESE. KA QENE VETE KVO-JA REFERUAR INFORMACIONIT TE MARE NEPERMJET SHKRESES NR.712/4.PROT NE PJESEN KU AK I KTHEN PERGJIGJE SHOQERISE SONE NE LIDHJE ME OFERTEN EKONOMIKE ANOMALISHT TE ULET TE SHOQERISE “SHKELQIMI 07” SH.P.K, QE KA RIVLERSUAR OFERTEN E OPERATORIT EKONOMIK DHE E KA KUALIFIKUAR ATE. NUK KUPTOHET SESI KVO-JA JASHTE PROCEDURES SE PARASHIKUAR NE LIGJ KA KRYER RIVLERESIM OFERTE KU PER TE NJEJTEN ARSYE E KA KRYER NJEHERE VLERESIMIN. JEMI TE MENDIMIT SE KY ESHTE NJE RAST I PAPRECEDENT DHE TERRESISHT ANTI-LIGJOR KU NJE KOMISION BRENDA INSTITUCIONIT MERE TAGRA DHE JEP VENDIME JASHTE KOMPETENCAVE TE SAJ TE PERCAKTUARA NE LIGJIN PER PROKURIMIN PUBLIK. NE RAST SE SHOQERIA ‘SHKELQIMI 07’ SH.P.K DO TE KISHTE PRETENDIME SE OFERTA E TIJ ISHTE S’KUALIFIKUAR PA TE DREJTE, ATEHERE AI DUHEJ TE ANKOHEJ NE AUTORITET, KU KOMISIONI I SHQYRTIMIT TE ANKESAVE DO TE VENDOSTE NESE PRANONTE ANKESEN E TIJ DUKE E KUALIFIKUAR SI OFERTE APO DUKE E LENE GJENDJEN E TIJ TE S’KUALIFIKUAR. Për sa mësipër oferta e shoqërisë “Shkëlqimi 07” Sh.p.k duhet të s’kualifikohet dhe vendimi i autoritetit kontraktor mbi rivleresimin e ofertës së këtij operatori duhet të shpallet i pavlefshëm.

II.2 Në kriteret kualifikuese pika 2.1 është kërkuar nga autoriteti kontraktor “Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave Vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2018, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKR.(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik,çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKR) ” Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” Sh.p.k në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifat vendore për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitet gjatë vitit 2018 për të cilat është regjistruar në QKB.

Në kriteret kualifikuese pika 5 është kërkuar nga autoriteti kontraktor “Deshmite per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates. Fudrome cope 1; Eskavator me goma cope 1 ” Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” Sh.p.k nuk ka paraqitur në tender leje qarkullimi, siguracion, kolaudim për mjetet Fadromë dhe Eskavator me goma, ku në kushtet kur të dyja këto mjete janë për qarkullim në rrugë duhet detyrimisht që të jenë të pajisura me leje qarkullimi.

Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” Sh.p.k nuk ploteson kerkesen “7. Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryetjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion se:Ka si drejtues teknik te punesuar dhe te regjistruar ne kompanine e tij minimalisht: Inxhinier Ndertimi; Inxhinier Hidroteknik dhe Inxhinier Topograf, të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë noteriale pune dhe CV”, pasi inxhinieret e paraqitur jane te deklaruar dhe te angazhuar ne proceduren “Rikonstruksioni i rruges Ramize Gjebrea, faza 2 (lidhja e rruges se pyllit te sodes me rrugen transballkanike dhe autostraden)”, ne te cilen kjo shoqeri eshte shpallur fituese ne daten 05.10.2018. Kontrata perkatese eshte lidhur ne daten 09.10.2018, perpara dates se hapjes se ofertave. Ky fakt ishte lehtësisht i vërtetueshëm prej autoritetit kontraktor nëpërmjet buletineve të paraqitura në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” Sh.p.k nuk ploteson kerkesen “5. Deshmite per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates” per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi mjetet e paraqitur ne kete procedure jane te deklaruar dhe te angazhuar ne proceduren “Rikonstruksioni i rruges Ramize Gjebrea, faza 2 (lidhja e rruges se pyllit te sodes me rrugen transballkanike dhe autostraden)”, ne te cilen kjo shoqeri eshte shpallur fituese ne daten 05.10.2018. Ky fakt ishte lehtësisht i vërtetueshëm prej autoritetit kontraktor nëpërmjet buletineve të paraqitura në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik. [...]”

II.10.Në datën 08.04.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.881/3prot., datë 03.04.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimes,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomikë ankimes, në zbatim të nenit 30, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.

2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, duke konstatuar se procedura e mësipërme e prokurimit është rivlerësuar në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, referuar informacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe

veprimet e tjera të autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”,

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Në datën 26.02.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Shkëlqimi 07” sh.p.k	8,000,000 lekë, Skualifikuar;
2. “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k.	9,129,835 lekë, Skualifikuar;
3. “B 93” sh.p.k & ”Riviera” sh.p.k.	9,648,550 lekë, Skualifikuar;
4. “Sark” sh.p.k	10,160,695 lekë, Skualifikuar;
5. “Sireta 2F” sh.p.k	11,111,000 lekë, Skualifikuar;
6. “Sardo” sh.p.k & ”Labi” sh.p.k.	11,111,300 lekë, Skualifikuar;
7. “Arbëria” sh.a	11,862,665 lekë, Kualifikuar;

III.1.2. Në datën 01.03.2019 BOE “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 622/4 Prot. datë 07.03.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k., duke e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

III.1.4. Në datën 12.03.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Shkëlqimi 07” sh.p.k	8,000,000 lekë, Kualifikuar;
2. “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k.	9,129,835 lekë, Kualifikuar;
3. “B 93” sh.p.k & ”Riviera” sh.p.k.	9,648,550 lekë, Kualifikuar;
4. “Sark” sh.p.k	10,160,695 lekë, Skualifikuar;
5. “Sireta 2F” sh.p.k	11,111,000 lekë, Skualifikuar;
6. “Sardo” sh.p.k & ”Labi” sh.p.k.	11,111,300 lekë, Skualifikuar;
7. “Arbëria” sh.a	11,862,665 lekë, Kualifikuar;

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezulton se për procedurën e prokurimit objekt ankimi, janë paraqitur pranë këtij të fundit, ankesa kundër vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave të datës 26.02.2019, nga operatorët ekonomik “B 93” sh.p.k, “Kevin Kontruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k. dhe BOE “Sardo” sh.p.k & ”Labi” sh.p.k., prej të cilave autoriteti kontraktor ka pranuar ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomik “B 93” sh.p.k dhe “Kevin Kontruksion” sh.p.k. & “Shpresa AI” sh.p.k., si dhe nuk ka pranuar ankesën e paraqitur nga BOE “Sardo” sh.p.k & ”Labi” sh.p.k. Sa më sipër, rezulton se rivlerësimi i ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k, dhe kualifikimi i këtij të fundit, është kryer me vetë-iniciativë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.1.6. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”*.

Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”*

Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”*.

Në nenin 63 pika 1 dhe pika 2 e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës. kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”*

Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përgjatë kësaj, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.”*

Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr. 914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *[...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor.*

Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik, Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura pasi autoriteti kontraktor dhe vetë KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave (ex officio). Si rregull, investimi i K.Sh.A dhe KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se rivlerësimi i procedurës së prokurimit në drejtim të kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k. është kryer nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, *ex officio*, pa një ankesë të legjitimuar në kuptim të nenit 63 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar. Akoma më tej, KPP sjell në vëmendje se në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përgjatë kësaj, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Referuar informacionit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor, rezulton se rivlerësimi i ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k. është bërë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pa një vendim të arsyetuar të zyrtarëve/zyrtarit të ngarkuar me shqyrtimin e ankesave (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave- KSHA). Sa më sipër,

KPP gjykon se për shkak të shkeljeve të mësipërme proceduriale, vendimi i autoritetit kontraktor është në shkelje të procedurës së parashikuar nga lex specialis dhe si tillë është absolutisht i pavlefshëm në kuptim të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”-së.

Në këto kushte, bazuar në nenin 64 pika 3/b të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, autoriteti kontraktor duhet të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik tërheq vëmendjen e autoritetit kontraktor dhe zyrtarëve përgjegjës, pasi kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.2.Lidhur me pretendimet e BOE ankimues “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa Al” sh.p.k. për kualifikimin e ofertës të paraqitur operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga BOE “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa Al” sh.p.k. për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Alit Gjeriti”, Patos”, me nr. REF-00204-12-19-2018, me fond limit 13,328,682 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Kevin Contruksion” sh.p.k. & “Shpresa Al” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 560 protokoli Datë 29.03.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha